



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MENAXHIMIT TË BORXHIT PUBLIK

N° 19320

af 26.12.13

UDHËZIM

NR. 30, DATË 26.12.2013

PËR

EMETIMIN NGA QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË,  
TË BONOVE TË THESARIT NË FORMË REGJISTRIMI

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe neneve 5 dhe 20 të Ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, Ministri i Financave,

**UDHËZON:**

**Neni 1**

**Objekti**

Objekti i këtij Udhëzimi është rregullimi i emetimit të bonove të thesarit në formë regjistrimi nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.

**Neni 2**

**Bonot e Thesarit**

**1. Përshkrimi**

Bonot e thesarit janë tituj qeveritarë me afat maturimi deri në një vit, të cilat emetohen dhe garantohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Bonot e thesarit mund te emetohen ne monedhë kombëtare ose të huaj. Shitia e tyre bëhet nëpërmjet ankandeve të cilat zhvillohen nga Banka e Shqipërisë, në emër dhe për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave.

Bonot e thesarit janë instrumente që tregtohen me zbritje. Përfitimi nga investimi në bono thesari llogaritet si diferençë e çmimit të blerjes së bonos së thesarit me vlerën nominale të saj. Në datën e maturimit paguhet vlera nominale e bonove të thesarit.

## Çmimi për blerjen e Bonove të Thesarit llogaritet si më poshtë:

$$C_b = \frac{V_n}{1 + \frac{y}{d} * D}$$

**C<sub>b</sub>** - çmimi i blerjes

**V<sub>n</sub>** - vlera nominale

**y** - yield (norma e interesit) i shprehur në bazë vjetore

**d** - ditë kalendarike

**D** - ditët deri në maturim

Për bonot e thesarit të emetuara në lekë, ditët kalendarike të përllogaritjes janë Act/365 ndërsa për bonot e thesarit të emetuara në valutë të huaj, ditët kalendarike të përllogaritjes janë Act/360.

### 2. Llojet e Bonove të Thesarit.

Zakonisht sipas afatit të maturimit bonot e thesarit ndahen në 3 mujore, 6 mujore dhe bono thesari 12 mujore, por Ministria në varësi të nevojave për likuiditet dhe në përputhje me politikat e saj, mund të emetojë bono thesari me afat maturimi fleksibël të cilat i nënshtronë të njëjtave procedura emetimi si bonot e thesarit me maturim standard.

Maturimi i bonove të thesarit është i shprehur në ditë. Në rast se dita e maturimit e specifikuar për çfarëdo emetimi të bonove të thesarit nuk është ditë pune në:

- a) Republikën e Shqipërisë ;
- b) sistemin e shlyerjes së pagesave në Bankën e Shqipërisë;
- c) sistemin e shlyerjes së pagesave të monedhave të huaja;

atëherë, pagesat do të bëhen në ditën pasuese të punës pa paguar interes ose ndonjë shumë tjetër që lidhet me vonesën në pagesë.

### Neni 3

#### Të drejtat e Ministrisë

Ministria, në varësi të kushteve të tregut dhe nevojave të huamarries, rezervon të drejtën e:

1. Mbajtjes në llogarinë e vet të tituje me Bankën e Shqipërisë, pjesë nga emetimi i saj i Bonove të thesarit. Ministria e Financave mund t'i shesë këto bono thesari në tregun sekondar, t'i mbajë deri në maturim ose t'i tërheqë pa njoftim paraprak.
2. Riblerjes se bonove te thesarit të emetuara më parë prej saj. Riblerja mund të bëhet nëpërmjet Ankandit të anasjelltë (reverse auctions) ose në mënyre të drejtpërdrejtë në treg sekondar. Karakteristikat e riblerjes përcaktohen në njoftimin që Ministria e Financave bën për riblerjen e bonove të thesarit.
3. Ndryshimit të shumave të shpallura në kalendarin tremujor, por në çdo rast ajo njofton pjesëmarrësit në tregun primar për këto ndryshime nëpërmjet njoftimit të radhës/ndryshimit të kalendarit.

### **Neni 3**

#### **Kalendari i emetimit të Bonove të Thesarit**

1. Ministria e Financave si përfaqësuese e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në emetimin e titujeve shtetërorë, për çdo tremujor, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të tremujorit përkatës, publikon kalendarin e emetimit të llojeve të ndryshme të bonove të thesarit. Në këtë kalendar, përcaktohet frekuencia e zhvillimit të ankandeve, datat dhe shumat indikative të emetimit sipas afateve të maturimit të bonove të thesarit.

2. Ministria në përputhje me politikat e saj për administrimin e borxhit, ka të drejtën të organizojë ankande jashtë radhës të përcaktuar në kalendarin tremujor. Këto ankande quhen ankande të jashtëzakonshme.

### **Neni 4**

#### **Ditët e ankandit dhe emetimit**

1. Ankandet për shitjen e bonove të thesarit do të zhvillohen si rregull ditën e martë. Nëse dita e martë nuk është ditë pune, dita e re e zhvillimit të ankandit njoftohet paraprakisht nga Ministria jo më vonë se dy ditë pune përpara zhvillimit të tij.

2. Dita e emetimit të bonove të thesarit si rregull do të jetë dita e enjte. Nëse dita e enjte nuk është ditë pune, dita e re e emetimit njoftohet paraprakisht nga Ministria jo më vonë se dy ditë pune përpara zhvillimit të ankandit.

3. Ankandet e jashtëzakonshme bëjnë përjashtim nga specifikimet e pikës 1 dhe 2 të këtij nenit.

### **Neni 6**

#### **Publikimi i zhvillimit të ankandit**

1. Ministria, si rregull jo më vonë se dy ditë pune përpara zhvillimit të ankandit, njofton dhe publikon të dhënat e mëposhtme:

- a) bonot e thesarit që do të emetohen, të detajuara sipas afateve të maturimit;
- b) shumat indikative të bonove të thesarit që do të emetohen, të detajuara sipas afateve të maturimit;
- c) datën e zhvillimit të ankandit për shitjen e bonove të thesarit;
- d) datën e emetimit të bonove të thesarit;
- e) datën e maturimit të bonove të thesarit;
- f) shumën e bonove të thesarit që do të blihen nga Banka e Shqipërisë.
- g) karakteristika të tjera të bonove të thesarit

Publikimi i të dhënave të mësipërme bëhet në platformën Reuters, në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë, në një televizion dhe gazetë kombëtare.

## **Neni 7**

### **Subjektet e lejuara për të marrë pjesë në ankand**

Subjektet të cilat kanë të drejtë të marrin pjesë në ankand janë:

- a) personat fizikë, vendas ose të huaj
- b) personat juridikë, vendas ose të huaj.

## **Neni 8**

### **Llojet e kërkesave për pjesëmarrje në ankand**

Kërkesat për pjesëmarrje në ankand janë: a) konkurruese dhe b) jo konkurruese.

1. Personat juridikë, vendas ose të huaj, mund të marrin pjesë në ankand vetëm me kërkesa konkurruese.
2. Personat fizikë, vendas ose të huaj, mund të marrin pjesë në ankand me kërkesa konkurruese ose jo konkurruese.

## **Neni 9**

### **Mënyra e paraqitjes së kërkesave në ankand**

1. Personat juridikë vendas ose të huaj si edhe personat fizikë vendas apo të huaj në çdo rast që paraqiten si konkurrues, mund të paraqitin kërkesat e tyre për pjesëmarrje në ankand:
  - a) në mënyrë të drejtpërdrejtë pranë Bankës së Shqipërisë;
  - b) nëpërmjet subjekteve të tjera të licenuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
2. Personat fizikë vendas apo të huaj duhet t'i paraqisin kërkesat e tyre jo konkurruese nëpërmjet sporteve të Bankës së Shqipërisë ose subjekteve te tjera të licenuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
3. Një subjekt ka të drejtë të paraqesë në ankand jo më shumë se pesë kërkesa konkurruuese me një ndryshim yield-i prej të paktën 0.01%.
4. Kërkesat për pjesëmarrje në ankand si rregull pranohen deri në orën 9.00 të ditës së ankandit, përvèç rasteve kur parashikohet ndryshtim në njoftimin e zhvillimit të ankandit. Pas kësaj ore, Komisioni i Ankandit nuk pranon asnje kërkesë për pjesëmarrje në ankand.

## **Neni 10**

### **Shuma minimale për pjesëmarrje në ankand**

1. Shuma minimale e lejuar për pjesëmarrje në ankandet e bonove të thesarit është 300,000.00 (treqind mijë) për bonot e thesarit në Leke dhe 2,000.00 (dy mijë) Euro/USD për bonot e thesarit në valutë.
2. Çdo kërkesë, vlera e së cilës kapërcen shumën 30,000,000.00 (tridhjetë milionë) për bonot e thesarit në Lekë apo 50,000.00 (pesëdhjetë mijë) Euro/USD për bonot e thesarit në valutë, klasifikohet si kërkesë konkurruese pavarësisht subjektit pjesëmarrës në ankand.

3. Vlera më e vogël e tregimit në treg primar apo sekondar është 10,000.00 (dhjetë mijë) për bonot e thesarit në lekë dhe 500.00 (pesë qind) Euro/USD për bonot e thesarit në valutë.

## Neni 11

### E drejta për përcaktimin e fituesve

- Ministria vendos për nivelin maksimal të pranuar të yield-it, në bazë të të cilit përcaktohen edhe fituesit e ankandit (blerësit e bonove të thesarit).
- Ministria, në marrjen e këtij vendimi, mban parasysh edhe shumën e shpallur për emetim të bonove të thesarit. Në varësi të nevojave të huamarrjes dhe kostos së saj, Ministria mund të zvogëlojë ose të anulojë shumën e ofruar dhe të shpallur.
- Ministria, ne përputhje me kushtet e tregut, ka të drejtë të pranojë shuma të ndryshme nga shumat indikative të ofruara për shitjen e bonove të thesarit, por duke mos e tejkaluar në asnje rast shumën totale të bonove të thesarit të ofruara dhe shpallura përpara ankandit.

## Neni 12

### Radha e përcaktimit të kërkesave fituese

- Bonot e thesarit që emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, i ofrohen për blerje në fillim Bankës së Shqipërisë, sipas shumës së kërkuar prej saj. Pjesa që mbetet, pasi ka blerë Banka Shqipërisë, ndahet si vijon: jo më shumë se 50 përqind për kërkesat jo konkuruese dhe pjesa tjetër për kërkesat konkuruese.
- Në rast se shuma totale e kërkesave jo konkuruese nuk e plotëson masën 50 përqind, atëherë diferenca e paplotësuar ofrohet për kërkesat konkuruese.
- Në rastin kur shuma totale e kërkesave jo konkuruese e kalon kufirin e përcaktuar 50 përqind, atëherë mbi këtë shumë zbatohet *pro-ratë*.
- Në rast se shuma e kërkesave konkuruese të kërkua nuk e plotëson masën 50 përqind, atëherë diferenca e paplotësuar u ofrohet kërkesave jo konkuruese (në rast kur këto të fundit e kanë tejkaluar kufirin 50 përqind)
- Bonot e thesarit në valutë u ofrohen në fillim për blerje kërkesave jo konkuruese dhe pjesa që mbetet plotësohet nga kërkesat konkuruese.
- Kërkesat konkuruese pranohen si fituese duke filluar nga ato që kanë përqindje yield-i më të ulët, derisa të plotësohet shuma e ofruar nga Ministria.
- Nëse shuma totale e kërkesave konkuruese në ankand e tejkalon shumën e ofruar nga Ministria, mbi kërkesën me yield-in më të lartë të pranuar, do të zbatohet *pro-ratë*.
- Në qoftë se për vlerën më të lartë të *yield-it* të pranuar nga Ministria rezulton më shumë se një kërkesë, atëherë pro-ratë zbatohet njëlloj mbi të gjitha këto kërkesa.
- Në rast se vlera totale e bonove të thesarit të shpallura për shitje në një ankand, rezulton më e madhe se sa shuma totale e kërkesave të pranuara (fituese) atëherë emetimi i bonove të thesarit konsiderohet i pjesshëm.

## Neni 13

### Rezultati i ankandit

Ministria, mbi bazën e të dhënave të ankandit, si rregull, jo më vonë se dy orë pas marrjes së informacionit mbi ankandin përcakton rezultatin e ankandit, të cilin:

- a) ia dërgon Bankës së Shqipërisë
- b) e publikon në platformën Reuters
- c) e publikon në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë

## Neni 15

### Kryerja e pagesës së vlerës nominale të bonove të thesarit

1. Fituesit e ankandit kanë të drejtë të tërheqin në çdo kohë diferencën e vlerës nominale me çmimin e blerjes së bonove të thesarit, duke filluar nga data e emetimit të bonove të thesarit deri në datën e maturimit të tyre.
2. Në datën e maturimit Ministria, nëpërmjet Bankës së Shqipërisë, kryen pagesën e vlerës nominale të bonove të thesarit.
3. Data e maturimit, si rregull është ditë pune.
4. Në rast se data e maturimit nuk është ditë pune, maturimi bëhet në ditën pasardhëse të punës.
5. Ministria është përgjegjëse për sigurimin e likuiditetit të nevojshëm në ditën e pagesës së vlerës së maturuar.

## Neni 16

### Veprimet që mund të kryejnë zotëruesit e bonove të thesarit gjatë periudhës së maturimit

1. Gjatë periudhës së maturimit, por jo më vonë se 1 ditë para datës së maturimit, zotëruesit e bonove të thesarit mund të transferojnë pronësinë mbi bonot e thesarit.
2. Zotëruesit e bonove të thesarit mund të transferojnë pronësinë mbi bonot e thesarit vetëm tek bankat.
3. Transferimi i pronësisë bëhet nëpërmjet regjistrimit të transferimit në regjistrat përkatës në të cilin bonot e thesarit janë regjistruar.

## Neni 17

### Veprimet që mund të kryejnë zotëruesit e bonove të thesarit në datën e maturimit

Në datën e maturimit, bonot e thesarit mund të investohen:

- a) për të njëjtën shumë;
- b) për një shumë më të madhe se vlera që maturohet,
- c) për një shumë më të vogël se vlera që maturohet sa kohë që kjo shumë nuk është më e vogël se 300,000.00 (treqind mijë) për bonot e thesarit në Lekë apo 2,000.00 (dy mijë) Euro/USD për bonot e thesarit në valutë.

## Neni 18

### Tatimi

Tatimi mbi bonot e thesarit mblidhet në përputhje me Ligjin nr. 8438, Datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

1. Tatimi për të ardhurat e përfituar nga investimi në bono thesari u mbahet në burim investitorëve që janë:
  - a) subjekte, që ushtrojnë aktivitet jo fitimprurës dhe për këtë arsyen të përjashtuar nga tatimi mbi fitimin;
  - b) individë (rezidentë ose jo rezidentë);
  
2. Tatimi për të ardhurat e përfituar nga investimi në bono thesari nuk u mbahet në burim, pasi këto të ardhura përfshihen në zërin e të ardhurave nga biznesi investitorëve që janë:
  - a) subjekte tatemore rezidente në Republikën e Shqipërisë që janë subjekte të tatum fitimit;
  - b) subjekte tatemore të regjistruar si tatimpagues të taksës vendore mbi biznesin e vogël;
  
3. Investitorët që gjëzojnë lehtësi dhe përjashtime, sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin nr. 8098, Datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbit", janë të përjashtuar nga tatimi, përvèç rasteve kur ky investim është bërë nga një subjekt që kryen veprimtari ekonomike.

### **Neni 19**

#### **Forca Madhore**

Ministria e Financave nuk mban përgjegjësi për ndonjë dëm të shkaktuar nga vonesat në ripagesat për bonot e thesarisit apo ndikimeve negative në çmimin e tregut për bonot e thesaris të shkaktuara nga:

- a- veprime të një autoriteti tjeter, luftë apo kërcënim lufte, apo revolta popullore;
- b- ndërprerje të rrjeteve të postave, rrjeteve telefonike, rrjeteve kompjuterike, komunikimeve elektronike, ndërprerje të energjisë elektrike, që mund ta ndikojë në shkallë të konsiderueshme punën e Ministrisë së Financave;
- c- një ndërprerje në punën e Ministrisë së Financave apo vonesë që mund të shkaktohet nga zjarri, tërmeti apo ngjarje te tjera natyrore te ngjashme;
- d- një konflikt apo grevë në forcën e punës që mund të ndërpresë në shkallë të konsiderueshme punën e Ministrisë së Financave;
- e- të tjera forca madhore që mund të ndikojnë punën e Ministrisë së Financave në shkallë të gjerë.

### **Neni 20**

Ky Udhëzim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të tij.

**SHKËLQIM CANI**

  
**MINISTERI I FINANCAVE**